



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:163362
Datë: 01.02.2024
Numri i dokumentit: 05273287

PA1.nr.1302/23

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës- Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mehmet Ndrecaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Azra Cakolli, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarit B.S., nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-se, duke vendosur sipas ankesës së te demtuares J.P., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr. 3738/2021 të datës 31.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18 Janar 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së te demtuares J.P., **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.3738/2021 i datës 31.10.2022 përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarit B.S., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, i shqipton dënimin me gjobe në shume prej 1000 (njëmije) euro, e te cilen gjobe eshte i obliguar qe ta paguaje ne afat prej 30 ditesh pas plotfuqishmerisë se aktgjykimit.

Në pjesën tjetër aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë mbetet i pandryshuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.3738/2021 të datës 31.10.2022, i akuzuari B.S., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-se, për të cilën është shpallur denimi me burgim në kohezgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, e me pelqimin e te akuzuarit e ne baze te nenit 44 te KPRK-se, denimi me burgim i eshte zevendesuar ne denim me gjobe ne shume prej 800 (teteqind) euro, e te cilen gjobe eshte obliguar qe ta paguaje pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.

E demtuara J.P., per realizimin e kerkeses pasurore juridike eshte udhezuar ne kontest civil.

I akuzuari eshte obliguar qe ti paguaje shpenzimet e procedures penale qe dalin sipas llogarise perfundimtare te Gjykates, ne emer te paushallit gjyqesor shumen prej 30 (tridhjetë) euro, ne emer te fondit per kompensimin e viktimave te krrimit shumen prej 30 (tridhjetë) euro, ne emer te ekspertizes mjeko ligjore shumen prej 20 (njezet) euro, si dhe per ekspertizen e komunikacionit shumen prej 40.88 Euro, e te gjitha keto ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

E demtuara J.P., per shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te procedures penale, vertetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykates se shkalles se pare te anulohet dhe qeshtja te kthehet ne rigjykim dhe vendosje.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesen e te demtuares J.P., me shkresën e vet PPA.II.nr. 1336/2023 të datës 16.10.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesen e te demtuares J.P., ta aprovoje si te bazuar, ta ndryshoje aktgjykimin e gjykates se shkalles se pare dhe te akuzuarit per vepren penale te kryer te i shqiptoje denim me burgim efektiv apo qe aktgjykimi i ankimuar te anulohet dhe qeshtja te i kthehet gjykates se shkalles se pare ne rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit mbajti seancen e kolegjit ne pajtim me nenin 390 paragrafi 1 te KPPRK-se, ne te cilen prezentoj vetem i akuzuari B.S., ndersa palet e tjera munguan dhe per te demtuaren J.P., eshte kthyer ftesa me konstatim nga nenpunesi i postes se e njejta ne adresen e cila gjendet ne shkresat e lendes dhe ne adresen te cilen e demtuara e ka konstatuar ne ankese eshte e panjohur, gjithashtu nga telefoni zyrtar i gjykates e njejta eshte ftuar edhe ne numrin e telefonit mobil te cilin e ka te shenuar ne ankese, mirepo nuk eshte lajmeruar me date 16.01.2024 ne ora 10:40, andaj seanca e kolegjit u mbajt ne pajtim me nenin 390 paragrafi 4 te KPPRK-se.

I akuzuari B.S., ne deklarimin e vet para kolegjit te Gjykates se Apelit e propozoi qe ankese e te demtuares J.P., te ushtruar kunder aktgjykimit te gjykates se shkalles se pare te refuzohet si e pabazuar, dhe i njejti deklaroi se denimin e zevendesuar me gjobe nga ana e gjykates se shkalles se pare ne shume prej 800 Euro e ka paguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore te demtuares J.P., dhe gjeti se :

- Ankese pjeserisht eshte e bazuar.

Sa i perket shkeljeve esenciale te dispozitave te procedures penale, e demtuara J.P., me ankese pretendon se shkelja esenciale konsiston se shqyrtimi gjyqesor eshte mbajtur pa personat prania e te cileve ne shqyrtimin gjyqesor kerkohet me ligj dhe se bazuar ne nenin 282 paragrafi 1 te KPPRK-se pala e demtuar eshte dashur te thirret dhe te jete prezente ne shqyrtim gjyqesor por e njejta nuk eshte thirrur, dhe duke mos qene prezente ne gjykate nuk

ka patur mundësi të paraqitjes së gjendjes së drejte shëndetësore të saj dhe se nuk i'u ka mundësuar deklarami rreth bashkangjitjes së ndjekjes penale dhe kërkeses pasurore juridike. E të gjitha këto shkelje sipas të demtuara aktgjyqimin e bëjnë të paqëndrueshem për qka të njejtin duhet anuluar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore të demtuara lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe konstatoi se të njejtat nuk janë të bazuara nga arsyeja se nga shkresat e lëndës shihet se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të shqyrtimit fillestar i ka dërguar ftesë të demtuara në adresën nga shkresat në lëndë, mirepo nga nenpunesi i autorizuar i postës ftesa është kthyer me konstatim se në adresën e cekur pala është e panjohur, andaj shqyrtimi fillestar ka filluar në prezencën e paleve prezente. Edhe për kundra faktit se e demtuara nuk ka prezantuar në shqyrtimin fillestar, gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktgjyqimit ka konsatuar se e njëjta për realizimin e kërkeses pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Nga këto, Gjykata e Apelit konstaton se nuk janë të bazuara pretendimet ankimore të demtuara lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale. Andaj, të njejtat i refuzoi si të pabazuara.

Sa i përket vertetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, e demtuara pretendon se në shqyrtimin gjyqësor do të prezantonte edhe dokumente tjera mjekësore përveq atyre që i ka propozuar prokuroria së bashku me aktakuzën, ashtu që edhe për gjykatën do të ishte një bindje tjetër faktike.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konstatoi se edhe pretendimet ankimore lidhur me vertetimin e gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike nuk janë të bazuara, ngase Gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform aktakuzës së ngritur me që rast i akuzuari në shqyrtimin fillestar të datës 25.10.2022 e ka pranuar fajesinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe është shpallur fajtor, ashtu siq është akuzuar, pra për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, që nënkupton se të demtuara J.P., i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të cilat janë konstatuar sipas akt ekspertimit mjeko ligjor me numër të referencës 08/2021.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, e demtuara J.P., me ankesë pretendon se e njëjta nuk është e kënqur fare me denimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit dhe se të njejtat është dashur që të i shqiptohet denim me i lartë.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit e Kosovës vlerësoi pretendimet ankimore të demtuara edhe lidhur me vendimin mbi denimin, dhe konstatoi se të njejtat janë pjesërisht të bazuara e sidomos edhe nga fakti se denimi i shqiptuar me burgim e i zëvendësuar në denim me gjobë për kundra faktit se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, konstaton se i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese si pranimin e fajesisë, mirepo nuk ka patur parasysh faktin se veprat penale nga lëmia e komunikacionit janë në rritje e sipër, andaj konstatoi se në rastin konkret duhet shqiptuar denim me të lartë me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjyqimi e i cili denim do të jetë në proporcion me peshën e veprës penale të kryer dhe rrezikshmerinë shoqërore të saj, e me bindje se me denimin e ndryshuar do të arrihet qëllimi i denimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij,

parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr. 1302/23 më 18.01.2024

Procesmbajtës
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit,
Mehmet Ndrecaj

Azra Cakolli
